

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8306  
E premte, 22 maj 2026  
Çmimi 0.50 €

Kosova rrezikon humbjen e fondeve të BE-së nëse vonon zbatimin e Agjendës së Reformave | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## ÇFARË DO TË NËNKUPTONTE XHANDARMËRIA PËR SIGURINË NË VERI? | FAQE 4-5



Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, njoftoi se janë ndërmarrë hapat e parë drejt themelimit të Xhandarmërisë së Kosovës. Ekspertët e sigurisë e shohin si

vendim strategjik themelimin e një strukture të tillë sigurie, që do të mund të kishte kompetenca në ruajtjen e kufirit me Serbinë. Ndërkaq sipas Sveçlës, krijimi i Xhandarmërisë do t'i

forcojë kapacitetet shtetërore për parandalimin, menaxhimin dhe neutralizimin e kërcënimeve "që cenojnë sigurinë e qytetarëve dhe integritetin territorial të vendit tonë"

### AKTUALE



**MERZI PROPOZON: BALLKANI PERËNDIMOR SI VËZHgues NË BE, UKRAINA SI ANËTARE E ASOCIUAR | F. 2**

**KUSH ËSHTË ALEATI KRYESOR I RUSISË NË BALLKAN? | F. 5**

**MBI 18 MIJË MATURANTË I NËNSHTROHEN TESTIT MË 20 QERSHOR | F. 6**

### EKONOMI



**AKK-ja AKUZON MINISTRINË E FINANCave PËR MOSFUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË TATIMIT NË PRONË | F. 8**

**BQK-ja DHE BANKAT DISKUTOJNË PËR MODERNIZIMIN E SISTEMEVE TË PAGESAVE | F. 8**

### SPORT



**PËRFAQËSUESI I UEFA-S VIZITON KOSOVËN, FOKUS ZHVILLIMI I REFERIMIT DHE STANDARDEVE NË FUTBOLL | F. 11**



**ARIAN TAHIRI: KURTI E ÇOI KOSOVËN NË ZGJEDHJE, REFUZOI KONSensusIN PËR PRESIDENTIN | F. 3**

**KURTI: MË 7 QERSHOR LE T'I KALOJMË 500 MIJË VOTA DHE TA SHËNOJMË FITOREN E RADHËS | F. 3**



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# MERZI PROPOZON: BALLKANI PERËNDIMOR SI VËZHgues NË BE, UKRAINA SI ANËTARE E ASOCIUAR

**BERLIN, 21 MAJ** - Kancelari gjerman Friedrich Merz propozoi që vendeve të Ballkanit Perëndimor t'u jepet statusi i vëzhguesit në Bashkimin Evropian, ndërsa Ukrainës statusi i së ashtuquajturës anëtare e asociuar pa të drejtë vote. Në një letër që Merz ua dërgoi liderëve të BE-së - presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, presidentit të Këshillit Evropian, Antonio Costa, si dhe presidentit qipriot Nikos Christodoulides, aktualisht kryesues i BE-së - ai vlerëson se nevojitet një dinamikë e re për Ukrainën, Ballkanin Perëndimor dhe Moldavinë.

Në letrën që "Radio Evropa e Lirë" e pa, Merz thekson se procesi i zgjerimit të BE-së është duke zgatur shumë dhe, sipas tij, kjo shkakton zemërim të kuptueshëm si te vendet candidate, po ashtu edhe te shtetet anëtare.

## Ballkani Perëndimor - vëzhgues në institucionet e BE-së

Për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Moldavinë, Merz propozon shqyrtimin e "zgjidhjeve inovative" për ta përshpejtuar procesin e anëtarësimit të tyre në BE. Ai sugjeron, mes të tjerash, qasje të privilegjuar në tregun e vetëm evropian dhe lidhje më të

ngushta me institucionet e BE-së në procesin e përditshëm të vendimmarrjes.

Ai, po ashtu, propozon dhënien e statusit të vëzhguesit për vendet e Ballkanit Perëndimor në të gjitha institucionet relevante të Bashkimit Evropian, si dhe mbajtjen e mbledhjeve të përbashkëta të Komisionit Evropian ose Parlamentit Evropian me përfaqësues të rajonit, për çështje që lidhen drejtpërdrejt me të. "Integrimi gradual mund të realizohet përmes ndërtimit të blloqeve që do të shërbenin si bazë për zbatimin e plotë të fushave përkatëse të politikave, dhe më pas do të shoqërohej me mbështetje më të madhe në zbatimin e ligjeve të BE-së. Përveç kësaj, mund ta avancojmë edhe integrimin institucional mbi bazën e progresit real. E gjithë kjo mund t'i afrojë ndjeshëm vendet candidate me ne dhe të nxisë një ambicie të re për reforma të mëtejshme drejt anëtarësimit të plotë", thuhet në letrën e kancelarit gjerman. "Të qëndrojmë fort të përkushtuar ndaj premtimit se vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Moldavia mund t'i bashkohen Bashkimit Evropian, siç është përcaktuar në Kriteret e Kopenhagës dhe në Agjendën e Selanikut të vitit 2003. Qëllimi ynë nuk ka ndryshuar: kompletimi i Bashkimit Evropian përmes përfshirjes së



të gjitha vendeve candidate", theksohet në letër.

Nga vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Bosnjë-Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut janë candidate për anëtarësim, ndërsa Kosova jo.

## Ukraina si anëtare e asociuar

Kreu i Qeverisë së Gjermanisë propozon që Ukrainës menjëherë t'i mundësohet të afrohet më shumë me Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij kryesore, "pa ndikuar në negociatat e vazhdueshme të pranimit, por duke inkurajuar dhe mbështetur atë proces". Sipas tij, statusi i "shtetit anëtar të asociuar" mund të përfshijë, ndër të tjera, pjesëmarrjen në takimet e

udhëheqësve ose ministrave të Bashkimit Evropian pa të drejtë vote, statusin e një anëtarit të asociuar të Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian, gjithashtu pa të drejtë vote, si dhe zbatimin gradual të ligjeve të Bashkimit Evropian në përputhje me përparimin e Ukrainës në negociatat e pranimit - "jo automatikisht, por pas miratimit të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe me klauzolat e përshtatshme mbrojtëse".

Merz, gjithashtu, propozon një mekanizëm automatik kthimi, në rast të kthimit prapa në vlerat themelore të Bashkimit Evropian, veçanërisht kur bëhet fjalë për sundimin e ligjit ose hapa prapa strukturorë në negociatat e pranimit. "Ukraina është anëtare e familjes evropiane dhe ne do të vazhdojmë ta mbështesim atë

në ndërtimin e një të ardhmeje paqësore dhe të begatë brenda Bashkimit Evropian. Me këtë qasje, Ukraina do të bënte një hap të madh përpara, duke i afuar menjëherë anëtarësimit të plotë. Ne do t'i ofronim Ukrainës një ekuivalent të rëndësishëm të anëtarësimit, që tejkalon shumë atë që do të mund ta arrinim në afat të mesëm përmes metodologjisë sonë të pranimit, veçanërisht duke marrë parasysh procesin e ratifikimit", thuhet në letrën e kancelarit gjerman.

Ai nënvizon, po ashtu, se propozimi për Ukrainën pasqyron situatën specifike të këtij vendi.

Paralelisht, thuhet në letër, Bashkimi Evropian do të vazhdojë me procedurën e rregullt të pranimit, për të siguruar që pranimi formal të arrihet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Kreu i Qeverisë gjermane beson se këto propozime nuk kërkojnë ndryshime në kuadrin institucional dhe ligjor të Bashkimit Evropian, por vetëm një "marrëveshje të fortë politike".

Ai shton se këto çështje mund të zgjidhen nëse evropianët marrin një qasje konstruktive ndaj këtij statusi të veçantë, sepse do të ishte një sinjal i fortë politik, për të cilin Ukraina dhe qytetarët e saj kanë nevojë në kohën e luftës së vazhdueshme të tyre kundër agresionit rus.

# TRUMPI: LUFTA MUND TË PËRSHKALLËZOHET NËSE IRANI S'JEP "PËRGJIGJET E DUHURA"

**UASHINGTON, 21 MAJ** - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha se është i gatshëm të presë "disa ditë" për përgjigjen e Iranit ndaj propozimit më të fundit të Uashingtonit që synon përfundimin e luftës, por paralajmëroi se situata mund të përshkallëzohet shpejt, nëse Teherani nuk jep "përgjigjet e duhura". "Më besoni, nëse nuk marrim përgjigjet e duhura, gjithçka mund të përshpejtohet. Ne të gjithë jemi gati", u tha Trump gazetarëve në një ngjarje në Konektikat.

I pyetur se sa gjatë është i gatshëm të presë, Trump tha: "Mund të jenë disa ditë, por gjithçka mund të ndodhë shumë shpejt". Më herët, gjatë fjalimit të tij në ceremoninë e diplomimit në Akademinë e Rojës Bregdetare të SHBA-së, Trump tha se Shtetet e Bashkuara mund të kryejnë sulme të tjera ndaj Iranit nëse negociatat dështojnë. "I goditëm shumë fort. Mund të na



duhet t'i godasim edhe më fort, por ndoshta jo", tha ai, duke përsëritur qëndrimin e administratës së tij për programin bërthamor të Iranit. "Nuk do ta lejojmë Iranin të ketë

armë bërthamore. Është shumë e thjeshtë", u shpreh Trump. Këto komente erdhën menjëherë pasi Ministria e Jashtme e Iranit deklaroi se Teherani po shqyrtonte një

propozim të ri amerikan, i cili thuhet se është dorëzuar përmes ndërmjetësve pakistanezë. Pakistani ka organizuar të vetmin rund zyrtar të bisedimeve të paqes Iran-ShBA,

që është mbajtur deri më tani, dhe që atëherë shërben si kanal kryesor i komunikimit midis dy palëve.

Trupat e Gardës Revolucionare Islamike të Iranit paralajmëruan më vonë se çdo sulm i ri nga ShBA-ja mund ta zgjerojë konfliktin "përtej rajonit".

Që nga 28 shkurti, ShBA-ja dhe Izraeli janë në konflikt të hapur me Iranin dhe aleatët e tij, pas një vale sulmesh ajrore që goditën objektiva ushtarake dhe shtetërore iraniane dhe eliminuan disa figura të larta, përfshirë udhëheqësin suprem, Ajatollah Ali Khamenei.

Sulmet ndodhën në mes të negociatave për programin bërthamor të Iranit, duke i dhënë një goditje të fortë diplomacisë.

Irani reagoi me raketa dhe dronë ndaj Izraelit, bazave amerikane dhe vendeve aleate në rajon, si dhe mbylli Ngushticën e Hormuzit, duke tronditur tregtinë globale.

## Kurti: Më 7 qershor le t'i kalojmë 500 mijë vota dhe ta shënojmë fitoren e radhës

GJILAN, 21 MAJ - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje!, Albin Kurti, ka thënë se më 9 shkurt të vitit të kaluar partia që drejton pati afër 400 mijë vota në zgjedhjet qendrore. Ndërkaq, sipas tij, "më 28 dhjetor arritëm bashkë afër 500 mijë vota". "E më 7 qershor le t'i kalojmë 500 mijë vota dhe ta shënojmë fitoren e radhës, edhe më të madhe e vendimtare, që t'i japim shtetit tonë institucione funksionale e



t'ia mbyllim bllokut opozitar shtigjet të cilat po i shfrytëzojnë për ta mbajtur shtetin peng. Nga Gjilani dhe Anamorava e vazhduam mobilizimin për zgjedhjet e ardhshme. Brezave aktual dhe atyre që do të vijnë pas nesh duhet t'ua lëmë trashëgimi një Kosovë gjithnjë e më të zhvilluar dhe prosperuese", ka shkruar Kurti në "Facebook". Kurti ka theksuar se po ndërtojnë shkolla dhe çerdhe.

"Po investojmë në ushtri, mbrojtje e siguri, me pajisje e armatim, industri dhe prodhim; po e rrisim mbështetjen për fëmijët dhe studentët, nënat lehona dhe të gjitha familjet. Dora e mirë e shtetit po prek aty ku më herët nuk shfaqej dot. 116 është numri, 7 qershori është dita, kur votojmë për progresin shoqëror, rritjen ekonomike dhe sigurinë shtetërore e qytetare", ka shkruar Kurti.

## HAMZA NË FAMILJEN THAÇI NË MITROVICË: ËSHTË KOHA T'I THEMI STOP KRIZËS DHE TA NDRYSHOJMË KOSOVËN

PRISHTINË, 21 MAJ - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës dhe kandidati për kryeministër, Bedri Hamza, ka vazhduar takimet me qytetarë në kuadër të fushatës zgjedhore, duke theksuar se ndryshimi duhet të vijë nga dëgjimi i drejtpërdrejtë i shqetësimeve të qytetarëve. Në rrjetet sociale, Hamza bëri me dije se kësaj radhe është mirëpritur nga familja Thaçi në Mitrovicë, ku ka biseduar për vështirësitë ekonomike dhe sociale me të cilat po përballen shumë familje. "Derë më derë, shtëpi më shtëpi, për të dëgjuar

nga afër nevojat dhe shqetësimet reale të qytetarëve tanë", ka shkruar Hamza. Kryefamiljari Besim Thaçi, profesor i teknologjisë, ka theksuar se situata ekonomike në vend është vështirësuar dukshëm gjatë viteve të fundit, pasi çmimet janë rritur vazhdimisht, ndërsa pagat kanë mbetur pothuajse të njëjta që nga koha kur, sipas tij, ato ishin rritur nga Hamza në cilësinë e ish-ministrit të Financave. Hamza ka vlerësuar se Kosova po kalon një krizë të thellë

ekonomike dhe sociale gjatë viteve të fundit, duke theksuar se çmimet e larta, pagat e vogla dhe mirëqenia e përkeqësuar janë bërë barrë për shumë qytetarë. Sipas Hamzës, është jetike që Kosovës t'i jepet një drejtim i ri politik dhe ekonomik, me rritje pagash e pensionesh, ulje të tatimeve, investime të mëdha në ekonomi, shëndetësi e arsim. "Prandaj është jetike t'i themi stop krizës dhe, bashkë, ta ndryshojmë Kosovën. Ky është misioni ynë. Ky është zotimi ynë", ka deklaruar ai.



## ARIAN TAHIRI: KURTI E ÇOI KOSOVËN NË ZGJEDHJE, REFUZOI KONSENSUSIN PËR PRESIDENTIN

PRISHTINË, 21 MAJ - Arian Tahiri, ish-deputet dhe zyrtar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka akuzuar kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, si përgjegjës për krizën politike dhe shkuarjen e vendit në zgjedhje të reja. Në "Përballje Podcast", me kryeredaktorin e "Telegrafi"-t, Muhamet Hajrullahu, Tahiri tha se, sipas PDK-së, përgjegjësia për mungesën e konsensusit politik bie mbi Kurtin dhe mënyrën se si ai ka udhëhequr procesin politik pas zgjedhjeve. Sipas tij,

kryeministri në detyrë nuk ka treguar vullnet për të arritur marrëveshje politike me partitë e tjera parlamentare. "Është veç një person, nuk është as subjekt politik, është veç një person, është Albin Kurti. Fajtori kryesor, shkaku kryesor se vendi po shkon zgjedhje është Albin Kurti. Sjellja e tij e papërgjegjshme... dhe mungesa e vullnetit të tij politik për ta arritur konsensusin", tha ai. Tahiri shtoi se është hera e parë që Kosova shkon në zgjedhje në një situatë kur partia fituese



kishte marrë mbi 50 për qind të votave. Ai e kritikoi Kurtin edhe për mënyrën e menaxhimit të procesit të zgjedhjes së presidentit, duke thënë se PDK kishte kërkuar marrëveshje politike dhe pajtim për

procesin por, sipas tij, Vetëvendosja kishte insistuar vetëm në emra konkretë. "Është hera e parë që vendi ynë shkon në zgjedhje në kohën kur Albin Kurti i ka fituar 51.1 për qind të votave... Ne kemi thënë: ti i ke 57 numra, ne i kemi 22, bashkërisht mund ta zgjedhim presidentin... Eja arrijmë marrëveshje për formën dhe procesin", deklaroi Tahiri. Ai tha se PDK kishte ofruar edhe mbështetje për një kandidat konsensual. Sipas ish-deputetit të PDK-së,

insistimi i Kurtit në emra individualë pa marrëveshje paraprake politike ka qenë arsyeja pse procesi ka dështuar. "Te kandidati konsensual nga familja Jashari e kemi ofruar mbështetjen e plotë, pa asnjë rezervë. Përderisa ne kemi qenë duke folur për procesin, për formën, ai përcjell emra", deklaroi Tahiri. Tahiri e akuzoi Vetëvendosjen se e ka përdorur krizën politike për ta larguar vëmendjen nga problemet ekonomike dhe sociale në vend.

## Gjini nga Juniku: Biznesi vendor është motori i ekonomisë, krijuesit e vendeve të punës janë partnerë të shtetit

JUNIK, 21 MAJ - Kandidati i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për kryeministër, Ardian Gjini, e ka nisur ditën e enjte me një vizitë në një kompani në Junik, duke vlerësuar rolin e bizneseve vendore në zhvillimin ekonomik dhe punësimin në vend. Gjatë vizitës në këtë kompani, e cila punëson mbi 100 persona, Gjini theksoi se pas çdo vendi pune qëndrojnë familje që jetojnë me dinjitet nga puna e ndershme, duke e

cilësuar biznesin vendor shtyllë e zhvillimit ekonomik të Kosovës. "Ky është motori i vërtetë i ekonomisë së Kosovës, biznese që zhvillohen këtu dhe na bëjnë krenarë në të gjithë botën. Biznesi vendor ka nevojë për terren të pastër që të zhvillohet dhe të punësojë edhe më shumë", ka deklaruar Gjini. Ai ka theksuar se qeveria e ardhshme duhet t'i trajtojë bizneset si partnerë të zhvillimit e jo si pengesë apo objekt presioni. "Sikush që krijon qoftë

edhe një vend të vetëm pune në Kosovë duhet parë si partner, jo si shënjestër. Me punë, mbështetje dhe zhvillim real mund ta forcojmë ekonominë dhe mirëqenien e qytetarëve", është shprehur Gjini gjatë vizitës në Junik. Vizita në kompani u paraqit si pjesë e angazhimit të kandidatit të Aleancës për të dëgjuar nga afër sfidat dhe nevojat e sektorit privat, me fokus krijimin e një klime më të favorshme për investime dhe punësim.





Armond NIMANI (AFP)

# ÇFARË DO TË NËNKUPTONTE XHANDARMËRIA PËR SIGURINË NË VERI?

Prishtinë, 21 maj - Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, njoftoi se janë ndërmarrë hapat e parë drejt themelimit të Xhandarmërisë së Kosovës. Ekspertët e sigurisë e shohin si vendim strategjik themelimin e një strukture të tillë sigurie, që do të mund të kishte kompetenca në ruajtjen e kufirit me Serbinë.

Sveçla shkroi në rrjetet sociale se ka nënshkruar themelimin e grupit punues që, sipas tij, do ta bëjë analizimin dhe propozimin e modaliteteteve për funksionimin e Xhandarmërisë si Agjenci e MPB-së. “Xhandarmëria përfaqëson një hap të rëndësishëm në konsolidimin e arkitekturës sonë të sigurisë, me mision të qartë për të garantuar prezencë të fuqishme shtetërore në funksion të ruajtjes së kufijve, integritetit dhe sovranitetit tonë territorial, mbrojtjen nga terrorizmi, menaxhimin e trazirave me rrezikshmëri të lartë dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike”, shkroi ai në Facebook. Sipas Sveçlës, krijimi i Xhandarmërisë do t'i forcojë kapacitetet shtetërore për parandalimin, menaxhimin dhe neutralizimin e kërcënimeve “që cenojnë sigurinë e qytetarëve dhe integritetin territorial të vendit tonë.

Serbia reagoi për vendimin e Kosovës, duke thënë se po bëhet “për të fituar poenë politike” nga kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, për zgjedhjet e qershorit.

Sipas Zyrës për Kosovën në Qeverinë serbe, “nuk ka bazë e as hapësirë” për Kurtin që të formojë “ndonjë njësit paramilitar apo parapollicor jashtë marrëveshjeve ekzistuese, aq më pak t'i dislokojë në zonat në veri të Kosovës”. “KFOR është forca e vetme legjitime e armatosur në Kosovë, përgjegjëse për kontrollimin dhe patrullimin përgjatë vijës administrative, dhe Kurti këtë e di shumë mirë dhe nuk mund ta ndryshojë realitetin me imazhe dhe premtime në fushatën zgjedhore”, u shtua në njoftim.

## Vrajolli: Xhandarmëria do të mund ta ruante kufirin me Serbinë

Drejtori i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), Mentor Vrajolli, e vlerëson vendim strategjik nismën për themelimin e Xhandarmërisë së Kosovës që, sipas tij, do të mund të merrte kompetenca për ruajtjen e kufirit me Serbinë, por edhe veprimeve të tjera në veriun e banuar me shumicë serbe. Duke folur për Radion Evropë

e Lirë, Vrajolli thotë se Kosova duhet të përgatitet për çdo ndryshim të rolit të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, ndonëse beson se ky mision do të qëndrojë për vite apo edhe një dekadë në vend.

Në këtë drejtim, ai kujton se shteti dhe KFOR-i kanë një marrëveshje që Forca e Sigurisë së Kosovës – që është në proces të transformimit në ushtri – të mos shkojë në veri pa pëlqimin e misionit paqeruajtës, duke thënë se Xhandarmëria do të mund të plotësonte këtë boshllëk. “Përderisa është një marrëveshje xhentlëmene mes KFOR-it dhe FSK-së që të mos jetë shumë prezente në pjesën veriore, Xhandarmëria do ta krijonte një strukturë të re, e cila nuk është pjesë e kësaj marrëveshje xhentlëmene”, thotë ai.

“Në njëfarë forme do të mundësonte që rolet e kontrollit kufitar dhe veprimeve të tjera që i bëjnë KFOR-i të jenë të përbashkëta me njësi që mund të jenë në kuadër të Policisë, apo në kuadër të MPB-së, e që do të fillonte sa më parë procesin e krijimit të kapaciteteve vendore dhe njohurisë se si të ballafaqohemi me kërcënime bashkërisht me KFOR-in në veri dhe pjesë të tjera të Kosovës”, shprehet Vrajolli.

Dërgimi i FSK-së në veri të vendit është i mundur vetëm me pëlqimin paraprak të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, bazuar në zotimin e vitit 2013 nga Qeveria e Kosovës ndaj NATO-s.

Radio Evropa e Lirë ka kërkuar një koment nga KFOR-i lidhur me paralajmërimin për themelimin e Xhandarmërisë dhe si e sheh misioni këtë vendim, dhe është në pritje të përgjigjes.

KFOR-i, që u vendos në vend më 1999, është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës dhe Misionit për Sundim të Ligjit të Bashkimit Evropian, EULEX. Megjithatë, misioni i NATO-s ka përgjegjësinë e sigurisë përgjatë kufirit të Kosovës me Serbinë.

Vrajolli thotë se ndonëse nuk dihet ende roli që do të ketë Xhandarmëria, ai vlerëson se nëse do të jetë si një degë e Policisë së Kosovës, atëherë do të pritej që kompetencat e Policisë Kufitare të barteshin te kjo strukturë e re, veçmas duke pasur parasysh që KFOR-i vazhdon të ruajë një pjesë të vijës kufitare.

Vrajolli beson se Kosova nuk ka nevojë që të ketë një xhandarmëri që do të merrej me incidente të brendshme, pasi vlerëson se Policia e Kosovës është e aftë të

ballafaqohet me to. “Pikërisht fakti që vija kufitare mbrohet nga KFOR-i, KFOR ka përgjegjësi të zgjeruara në këtë fushë dhe nevojitet që në të krijojmë institucionet tona që janë të gatshme ta zëvendësojnë KFOR-in kurdo që KFOR-i nuk është aty”, thotë Vrajolli, duke shtuar se beson që ky mision do të ketë mandat për vite apo dekadë në Kosovë.

Sipas tij, çdo çalim nga ana e Kosovës, kurdo që KFOR-i largohet nga vendi “mund të jetë fatale për vetë sovranitetin të Kosovës dhe madje kërcënime ekzistenciale për sigurinë e Kosovës”. “Mendoj që është vendim strategjik dhe kontribuon në fuqizimin e rendit dhe sigurisë në Kosovë”, vlerëson ai.

Ndërkaq, së voni ka pasur zëra për reduktim apo tërheqje të trupave amerikane nga Evropa, teksa në Gjermani, Pentagoni ka njoftuar për tërheqjen e një pjese të trupave. Megjithatë, Uashingtoni nuk ka paralajmëruar ndonjë tërheqje të mundshme nga KFOR-i.

Edhe Vrajolli beson se një tërheqje amerikane nga Evropa është çështje dekadë, por vlerëson se Kosova duhet të përgatitet që të marrë vetë në duar sigurinë e saj.

Ai thotë se ky vendim i

# KUSH ËSHTË ALEATI KRYESOR I RUSISË NË BALLKAN?

PRISHTINË, 21 MAJ - Llogaritja e lidhjeve të vendeve të Ballkanit me Rusinë është në interes të Moskës, por jo meritë e saj, thotë Paolla Petriq, drejtoreshë e Zyrës së Fondacionit "Heinrich Boll Stiftung" në Sarajevë, për Radion Evropa e Lirë. "Ballkani është një nga zonat e saj të ndikimit ose një nga pikat përmes të cilave përpiqet ta trazojë gjeopolitikisht Evropën dhe Bashkimin Evropian dhe ta pengojë integrimin euroatlantik të kësaj pjese të Evropës. Kjo është në interes të Moskës, ndërsa përgjegjësia është tek elitat lokale, se çfarë aleancash krijojnë dhe nëse i çojnë ato drejt Brukselit ose jo", shpjegon Petriq. Aleancat që Moska i mban pas vitit 2022 dhe fillimit të zbatimit të sanksioneve të Bashkimit Evropian ndaj Rusisë, për shkak të pushtimit të Ukrainës, në Ballkan shpesh shihen përmes shembullit të Serbisë.

## Sa kanë ndryshuar marrëdhëniet Beograd - Moskë?

Edhe pse Serbia është kandidate për anëtarësim në BE, ajo nuk i ka vendosur sanksione Rusisë, duke rrezikuar kështu procesin e saj të integrimi evropiane, i cili përfshin edhe harmonizimin gradual të politikës së jashtme me atë të Brukselit. Por, në të njëjtën kohë, në marrëdhëniet Beograd-Moskë janë shënuar edhe ngecje të dukshme. Momenti më i ndjeshëm ndodhi rreth një vit më parë, kur Shërbimi i Inteligjencës së Jashtme të Rusisë e akuzoi Beogradin se armët e prodhuara në Serbi, përmes vendeve të treta, janë duke përfunduar në duart e forcave ukrainase. "Kjo i mundëson Kievit të marrë formalisht produkte të industrisë ushtarake që nuk janë më serbe, por që montohen në fabrikat e armëve në vendet

perëndimore. Montimi dhe mbushja e municionit kryhen kryesisht në Çeki dhe Bullgari", thuhej në deklaratën e Moskës në qershor të vitit 2025. Drejtoresha e Qendrës për Edukim Qytetar nga Podgorica, Dalliborka Ulareviq, vlerëson se Rusia nuk ka shumë alternativa dhe se, për këtë arsye, në marrëdhëniet me partnerët e saj toleron shumë gjëra që në rrethana të tjera nuk do t'i pranonte. "Serbia mbështetet te Rusia edhe për shkak të çështjes së Kosovës. Nga ana tjetër, Rusisë i duhet një shtet i madh, përmes të cilit mund të ushtrojë ndikime të tjera, pasi një pjesë të ndikimit në Bosnje dhe Hercegovinë e ka ushtruar përmes Serbisë. Tani, kjo po ndodh në mënyrë më të pavarur në Republikën Sërpska", thotë Ulareviq për Radion Evropa e Lirë.

## A është Dodiku "më i suksesshëm" se Vuçiçiq?

Millorad Dodik, udhëheqës i partisë kryesore të serbëve në Bosnje dhe Hercegovinë, është takuar nëntë herë me presidentin rus, Vladimir Putin, që nga fillimi i pushtimit të Ukrainës në shkurt të vitit 2022. Dodik, i cili u detyrua të tërhiqej nga pozita e presidentit të entitetit Republika Sërpska pas një vendimi gjyqësor, për shkak të mosrespektimit të vendimeve të përfaqësuesit të lartë ndërkombëtar në Bosnje dhe Hercegovinë, u hoq në tetor të vitit të kaluar edhe nga lista e sanksioneve amerikane, ku gjendej që nga viti 2017. Në këtë mënyrë, Dodik arriti një pozitë balancimi, që është strategji shumëvjeçare edhe e presidentit serb, Aleksandar Vuçiçiq. "Ky balancim pragmatik që Millorad Dodik po e zbaton tani në praktikë, nuk është i qëndrueshëm në thelb. Lëvizjet që lidhen me Dodikun janë bërë me siguri në koordinim me Moskën, por afati i tyre është i kufizuar nga administrata aktuale në



Uashington. Për më tepër, ka pasur tashmë edhe një krisje në komunikimin mes Dodikut dhe Vuçiçiqit. Nuk duhet harruar se ai, për një periudhë, është kritikuar edhe në mediat e Beogradit", thotë Ulareviq. "Dueti që luhet në marrëdhëniet Banja Llukë - Beograd është gjithashtu një konstante në Ballkanin Perëndimor dhe ndonjëherë, si në një marrëdhënie të vështirë dashurie, mund të ndodhë një qetësi e përkohshme", thekson në anën tjetër Petriq.

## Kush është aleati rus në BE pas Orbanit?

Me humbjen e kryeministrit hungarez, Viktor Orbanit, pas 17 vjetësh në pushtet, Rusia ka mbetur pa një aleat brenda Bashkimit Evropian. Në shënimin e Ditës së Fitores më 9 maj në Moskë, përveç Dodikut, i pranishëm ishte edhe kryeministri sllovak, Robert Fico. Sllovakia, përmes gazsjellësit "Druzhba", mbetet e varur nga importi i gazit rus, ashtu si edhe Bullgaria, e cila, megjithatë, i ka ulur ndjeshëm importet që nga viti 2022, duke u mbështetur më shumë në furnizime nga Azerbajxhani përmes Greqisë dhe Turqisë. Por, pavarësisht prej kësaj, kryeministri bullgar, Rumen Radev, nga pozita e qendrës së djathtë, e mbështet vazhdimin e importit nga Rusia.

Tsvetomir Nikollov, bashkëpunëtor i Qendrës për Studimin e Demokracisë në Sofje, vlerëson se rëndësia e Radevit për Moskën është rritur. "Kur je pjesë e BE-së dhe NATO-s, je brenda dhe është shumë më e rëndësishme të kesh instrumente të tilla, në mënyrë që të mund të bllokosh qëndrime apo hapa të caktuar politikë, duke përdorur mundësinë e vetos dhe mekanizma të ngjashëm", thotë Nikollov.

Ai shton se është pak e mundshme që Radev të luajë në të ardhmen rolin e një aleati rus në Evropë, siç ka bërë Orban. "Regjimi i Orbanit nuk ka qenë aq efektiv sa ç'prisnin aktorët rusë, sepse Hungaria është në një pozitë ndryshe... Ajo është një lojtare e rëndësishme në botë, jo vetëm në Evropë", shpjegon Nikollov, duke kujtuar gjithashtu se lëvizja MAGA (Ta bëjmë Amerikën sërish të madhe) në ShBA është frymëzuar pjesërisht edhe nga politika e brendshme hungareze.

## Ku ndryshon populizmi në Ballkan dhe në BE?

Rritja globale e populizmit u jep forcë edhe përpjekjeve të Rusisë në politikën e jashtme. Në Ballkan kjo tendencë është e dukshme në Serbi, por në mënyrë të ngjashme mund të shihet edhe përmes rritjes së

partisë Alternativa për Gjermaninë (AfD) në Gjermani, mbështetjes që gëzon Fico në Sllovaki, apo populizmit të djathtë të kryeministres italiane, Giorgia Meloni.

Në Mal të Zi - vendin që konsiderohet ndër më të avancuarit në procesin e anëtarësimit në BE - besohet se, pavarësisht ndarjeve ideologjike, është arritur një lloj konsensusi për orientimin evropian. "Narrativët prorusë nuk janë zhdukur. Ata sot, në këtë moment kur thoni se Mali i Zi ka avancuar mjaft në rrugën drejt BE-së, kanë aktorët e tyre në pushtet, kanë një pjesë të hapësirës mediatike, rrjetet sociale dhe narrativë më të gjerë identitare e gjeopolitike që shpesh përputhen me ndjenja të forta proserbe dhe antiperëndimore", thotë Ulareviq.

Ajo kujton, gjithashtu, se Mali i Zi ka mbyllur 13 nga gjithsej 33 kapitujt e negociatave për anëtarësim në BE.

Mbyllja e të gjithë kapitujve është kusht për anëtarësim, që do të thotë se ngecja në 20 kapitujt e mbetur mund të ketë një kosto të lartë.

Sipas Petriqit, "dështimi në vendosjen e demokracisë" është arsyeja pse populizmat në Ballkan janë më të rrezikshëm sesa ata që janë zhvilluar në shtetet e BE-së. "Kur them demokraci, mendoj për ndarjen bazike të pushteteve që nënkupton një demokraci. Ne vazhdimisht ngecim në këtë bazë, në themelet e demokracisë dhe nuk arrijmë kurrë të ndërtimi i mëtejshëm. Pra, ky është një dallim i madh", thotë ajo.

"Kur flasim për atë se sa e paqëndrueshme është sot demokracia gjermane, ne e dimë se atje themelet janë - për momentin - shumë të forta; ato mund të lëkunden, por janë rezistente ndaj tronditjeve. Ndërsa te ne, demokracia ende nuk është e aftë t'u rezistojë tronditjeve", përfundon Petriq.

Kosovës për krijimin e një strukture të re sigurie u bë publik në një moment kur Perëndimi ka një përçarje. "Pastaj, ka një tendencë nga SHBA që problemet e Evropës t'ia lërë vetë në dorë Evropës dhe për ne është jashtëzakonisht me rëndësi që të përgatitemi për çfarëdo skenari që mund të pasojë si rezultat i kësaj qasjeje. Mendoj që nuk ka rrezik që shumë shpejt trupat amerikane të tërhiqen, edhe në Gjermani vetëm një numër i caktuar u tërhoq. Mendoj që tërheqja e trupave amerikan është çështje dekadë. Mendoj që ne duhet të sigurohemi që për

nevojat e sigurisë të jemi të gatshëm", thotë ai. Vrajolli thotë se Serbia - që nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe e konsideron atë pjesë të saj - është kërcënimi kryesor i sigurisë, duke shtuar se ka qenë e gabuar bindja e mëhershme se konflikti me Beogradin i përket së shkuarës. "Tani, me incidentin në Banjskë pamë që megjithatë nuk është i të kaluarës. Ajo që figuron në Kushtetutën serbe apo dokumentet e strategjisë së Serbisë nuk duhen injoruar, Serbia përbën kërcënim të drejtpërdrejtë të sigurisë sonë dhe ushtarake, edhe mes

strukturave të tjera të sigurisë. Ne duhet të jemi të aftë, qoftë në kuadër të FSK, Policisë dhe Xhandarmërisë që të ballafaqohemi me të gjitha rreziqet, qofshin të drejtpërdrejta, tradicionale apo hibride, që gjasat më të mëdha do të jenë më hibride si rasti Banjska", thotë ai. Kosova e vlerëson si terrorist sulmin ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit në shtator të vitit 2023, kur një grup i serbëve të armatosur vrau një polic të Kosovës. Prishtina ka fajësuar Beogradin për këtë sulm, por ai ka mohuar çdo përfshirje në të.

## Xhandarmëritë e shteteve të tjera

Xhandarmëria është një forcë e sigurisë me karakter ushtarak që kryen detyra policore. Në disa shtete mund të jetë pjesë e Ministrisë së Brendshme, në të tjera pjesë e forcave të armatosura. Shumë shtete kanë xhandarmërinë e tyre, përfshirë edhe fqinji verior i Kosovës, Serbia, xhandarmëria e së cilës funksionon në kuadër të policisë. Xhandarmëri kanë edhe shtete të tjera, sikurse Franca,

shtet anëtar i NATO-s. Shembull, Xhandarmëria e Francës është forcë ushtarake që ka për detyrë sundimin e ligjit, ka juridiksion të plotë mbi popullatën civile dhe është përgjegjëse për sigurinë publike, rendit publik dhe ndërvepron me forcat policore dhe ushtarake brenda dhe jashtë vendit. Ajo luan rol në menaxhimin e krizave dhe merr pjesë edhe në misione paqësore jashtë vendit, por edhe në operacione luftarake. Në NATO, forcat e llojit të xhandarmërisë përmenden në kuadër të asaj që njihet si policia për stabilitet.

## Shtëpitë e drurit nga Kosova po eksportohen në tregjet evropiane

PRISHTINË, 21 MAJ - Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, ka vizituar fabrikën "GreenHouse" në Zahaq të Pejës, në prag të hapjes zyrtare të saj, duke vlerësuar këtë investim si një shembull i rëndësishëm i zhvillimit të industrisë prodhuese dhe eksportuese në Kosovë.

Fabrika "GreenHouse", e themeluar nga Nazmi Mehmetaj dhe Visar Rexhepaj, është rezultat i përvijës shumëvjeçare të fituar në Zvicër, ku themeluesit kanë ushtruar të njëjtin veprimtari profesionale. Me besim në potencialin ekonomik të Kosovës, ata kanë vendosur të investojnë në vendlindje dhe t'i rikthejnë familjet e tyre për të

jetuar dhe ndërtuar të ardhmen në Kosovë.

Ky investim, i nisur në vitin 2015, sot ka rreth 40 punëtorë të angazhuar, përfshirë edhe gra të punësuar, ndërsa pjesa më e madhe e fuqisë punëtore vjen nga rajoni i Pejës, duke ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik lokal dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Gjatë vizitës u theksua se fabrika është e pajisur me teknologji moderne, robotikë dhe makina bashkëkohore të prodhimit. Lënda e parë importohet nga Gjermania dhe Austria, ndërsa përpunimi dhe prodhimi realizohen në Kosovë.

Produktet e kompanisë tashmë eksportohen në disa vende evropiane, përfshirë Zvicrën,



Gjermaninë, Luksemburgun, Francën, Italinë, Islandën dhe Holandën, ndërsa interesim ka pasur edhe nga tregu amerikan.

## ABDIXHIKU: ALUSH GASHI ISHTE NJË KUJTESË E GJALLË E KOSOVËS SONË MODERNE

PRISHTINË, 21 MAJ - Nën përkujdesjen e kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, të enjten është mbajtur mbledhje përkujtimore, në nderim të jetës dhe veprës së veprimtarit të shquar, anëtarit të Kryesisë, një prej themeluesve të LDK-së e bashkëpunëtorit të ish-presidentit Rugova, prof. Alush Gashi. "Në vitet tona të afërsisë, pata fatin të ndaj me profesor Alush Gashin shumë udhëtime. Kryesisht në qendra të mëdha botërore; në Uashington, Londër, Paris, Bruksel, Berlin e gjetiu; në institucione ku vendosen fatet e kombeve të vogla si i yni. Dhe në secilin prej atyre udhëtimeve, unë nuk po udhëtoja vetëm me një bashkëpunëtor politik. Po udhëtoja me një kujtesë të gjallë të Kosovës sonë

moderne", ka thënë Abdixhiku. Ai ka shtuar se udhëtimet nuk mbeten vetëm kujtime institucionesh e takimesh. "Mbetën mbi të gjitha kujtime bisedash. Do të shkruaj një ditë për to. Kam çka flas. Ishin biseda të gjata, të ngrohta, shpesh të qeta, shpesh plot humor, që vetëm miqtë e vërtetë dinë t'i kenë. Flisim për politikën, natyrisht. Për Kosovën, për LDK-në, për njerëzit, për kohët që kishin kaluar e për kohët që po vinin. Por po aq shpesh flisim për jetën, sfidat dhe të bukurat e saj. Dhe në ato biseda e kuptoj se sa i thellë ishte si njeri. Ishte një 'jack'! Fliste, po ashtu, me një mburrje të bukur për dy djemtë e tij, Anilin dhe Arbanin. Ishte ajo mburrja e qetë e një babai që nuk ka nevojë të stërmadhojë asgjë, sepse krenaria i dilte



natyrshëm prej zemrës. E shihje në sy sa shumë i donte, sa shumë i admironte, sa shumë e shihte veten tek ata. Dhe po aq bukur fliste për Ilirianën - me një dashuri të qetë, të thellë, të pashfaqur me shumë fjalë, por të dukshme në secilën fjali të tij. Kishte diçka shumë njerëzore në mënyrën si fliste për familjen. Të kujtonte se, pavarësisht gjithë historisë që mbante mbi supe, në fund mbetej një njeri i familjes së vet. Dhe po, kemi qeshur shumë bashkë. Në ato të qeshurat tona e humorit të

zi, i kam premtuar, që do ta ja bëja një fjalim të bukur në akademi mortore një ditë. Profesor, nuk e kam menduar kështu. Jo kaq herët. Jo kaq papritur. Jo pa u përshëndetur. Por jeta s'na pyet, as mua e as ty. Dhe ndoshta kjo është pjesa më e vështirë e lamtumirave. Sepse ka njerëz që nuk të mungojnë vetëm në kujtesë. Të mungojnë në përditshmëri", ka thënë Abdixhiku.

Bashkëshortja e Alush Gashit, Iliriana Gashi, në mbledhjen përkujtimore ka thënë se është e vështirë për të që të flasë pas gjithë fjalëve që u thanë për bashkëshortin e saj. Ajo i ka falënderuar të gjithë pjesëmarrësit që morën pjesë në mbledhje, duke shtuar se në jetën e tyre ka pasur shumë sfida. "Është shumë e vështirë me fol tash pas gjithë këtyre fjalëve të bukura. Kisha dashtë

me ju falënderuar të gjithëve në emër të familjes që keni ardhur për ta nderuar Alushin dhe neve si familje. Dua t'i falënderoj shumë, të gjithë ata, të cilët gjatë këtyre ditëve pas lajmit të kobshëm që morëm na kanë qëndruar afër në mënyra të ndryshme. Me qindra postime të bukura, mesazhe të bukura, dhe telefonata që janë munduar me nda dhimbjen me ne, dhe na kanë lehtësuar këtë dhimbje", ka thënë ajo. "Faleminderit shokëve të Alushit. Dua t'i falënderoj më së shumti ata, të cilët, Alushit i kanë ndenjur afër në kohëra të vështira. Si u tha deri tash, në jetën tonë ka pasur shumë sfida, kemi jetuar në kohë sfida. Ai nuk është kursyer, por ka kaluar nëpër gjëra të vështira", ka thënë bashkëshortja e Alush Gashit.

## MBI 18 MIJË MATURANTË I NËNSHTROHEN TESTIT MË 20 QERSHOR

PRISHTINË, 21 MAJ - Më 20 qershor mbi 18 mijë maturantë do t'i nënshtrohen Testit të Maturës Shtetërore.

Drejtuës të Ministrisë së Arsimit kanë bërë me dije se testi do të organizohet në një ditë dhe përbëhet nga tri lëndë të përgjithshme dhe një zgjedhore.

Edhe këtë vit aplikimi do të bëhet përmes platformës online, e cila do të hapet më 1 qershor.

Testi i Maturës Shtetërore këtë

vit do të organizohet më 20 qershor në afatin e qershorit dhe më 29 gusht në afatin e gushtit.

Udhëheqësi i Divizionit për Vlerësim, Standarde dhe Monitorim në Ministrinë e Arsimit, Fatmir Elezi, në një përgjigjeje për "Radio Kosovën" ka thënë se këtë vit mbi 18 mijë maturantë do t'i nënshtrohen Testit të Maturës Shtetërore. "Testi i Maturës me vendim të ministrit është caktuar të mbahet më 20 qershor për



afatin e qershorit dhe 29 gusht afati i gushtit. Kemi diku rreth 18 mijë e 300 maturantë të rinj dhe maturantët që kanë mbetur nga vitet e kaluara, pritet prapë t'i nënshtrohen testit të maturës. Këtë vit

aplikimi i nxënësve do të bëhet nëpërmes platformës e Kosova. Platforma online për aplikim do të hapet nga 1 qershor dhe maturantët do të kenë mundësi që deri më datë 12 qershor të paraqesin provimin e maturës", ka theksuar Fatmir Elezaj.

Ai ka folur edhe për Ligjin e Ri të Maturës që, sipas tij, i jep më shumë kompetencë Inspektoratit Arsimit i cili do ta mbikëqyrë. "Siç e dini, këtë vit është miratuar Ligji i Ri i Maturës dhe përbërja e

komisionit është e ngjashme me vitet paraprake, mirëpo diçka e re këtë vit është se ky ligj i ka dhënë rol të posaçëm Inspektoratit të Arsimit i cili do ta mbikëqyrë procesin", ka thënë ai.

Testi i Maturës Shtetërore do të organizohet brenda një dite për një afat ku nxënësit do t'i nënshtrohen testit në tri lëndë të përgjithshme: Gjuhë Shqipe, Matematikë, Gjuhë Angleze dhe një lëndë me zgjedhje që përzgjidhet nga nxënësi.

## Sekuestrohen rreth 8 kg ari dhe argjend në Prizren, vlera mbi 460 000 euro

Prizren, 21 maj - Prokuroria Themelore në Prizren, në koordinim me Njësinë Rajonale për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prizren, si dhe në bashkëpunim me Doganën e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), ka zhvilluar veprime hetimore lidhur me dyshimet se disa biznese për shitjen e arit në qytetin e Prizrenit janë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, duke iu

shmangur detyrimeve doganore dhe tatimore lidhur me tregtimin e arit dhe argjendit. "Pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore që kanë nisur nga data 19.09.2025, me urdhër të prokurorit të çështjes, me datë 20.05.2026, janë realizuar kontrolle në gjashtë lokale afariste në qytetin e Prizrenit, si dhe në tri shtëpi banimi. Gjatë kontrolleve janë siguruar dëshmi materiale dhe është hasur sasi e konsiderueshme e arit

dhe argjendit të padeklaruar, dhe është iniciuar rast ndaj katër personave për veprat penale 'Shmangia nga tatimi' nga neni 307 dhe 'Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore' nga neni 312 të KPRK-së. Nga kontrollet e realizuara janë sekuestruar gjithsej: 3.775,33 gram ari i padeklaruar, në vlerë të përafërt prej rreth 455.000 euro; 4.204,98 gram argjend i padeklaruar, në vlerë të përafërt prej rreth



8.900 euro", ka njoftuar Prokuroria Themelore në Prizren.

Po ashtu, është bërë me dije se gjatë kontrolleve në dy lokacione të ndryshme janë gjetur dhe sekuestruar dy armë/pistoleta pa leje dhe

është iniciuar rast për veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 366 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Prizren, në bashkëpunim me institucionet relevante të zbatimit të ligjit, mbetet e përkushtuar për ndjekjen e rasteve të shmangies nga tatimi, evazionit doganor dhe çdo forme tjetër të kriminalitetit ekonomik. Hetimet lidhur me këtë rast janë duke vazhduar.

## Rama: Qeveria po bllokoi projektin që lidh 30 mijë banorë me qendrën e Prishtinës

PRISHTINË, 21 MAJ - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka akuzuar qeverinë për bllokim të qëllimshëm të një projekti urban që, sipas tij, do të lidhte mbi 30 mijë banorë me qendrën e qytetit. Rama ka deklaruar se bëhet fjalë për një platformë që, përveç lidhjes së dy pjesëve të qytetit, do të shërbente edhe për rritjen e sigurisë dhe lehtësimin e qarkullimit për qytetarët. Sipas tij, komuna e



Prishtinës tashmë e ka ndarë buxhetin, e ka realizuar projektin dhe kanë nisur punimet, por ato po ndalohen nga institucionet qendrore. "Ishulli urban që

lidh 30,000 banorë të 'Arbërisë' me qendrën po bllokohet. Një platformë që jo vetëm lidh dy pjesë të qytetit, por shërben edhe për siguri, po bllokohet prapë qëllimisht. Ne si Kryeqytet e kemi nda buxhetin, e kemi realizuar projektin dhe kanë filluar punimet, ndërsa këta dalin dhe i ndalin punimet. I ndalojnë punimet e komunës, ndërsa biznesit privat i jepet leja! Ky seleksionim kallëziona

sa hipokritë janë. I bllokojnë 500,000 banorë për interesa politike. Këta bëjnë politikë me nevojat bazike të qytetarëve. Po, Prishtina nuk ka me mbet peng i bllokadave të kësaj qeverie. Nuk lejoj që qytetarët e Prishtinës me u blloku prej njerëzve të paafte dhe dashakëqij! Prandaj ftoj prokurorinë që menjëherë me u marrë me këtë çështje", ka thënë Rama në deklaratën për medie.

## TË RESPEKTOHET PAVARËSIA INSTITUCIONALE E KOMUNAVE NGA NIVELI QENDROR

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 MAJ - Asociacioni i Komunave të Kosovës ka organizuar takim të radhës me Kolegjiumin e Menaxherëve të Burimeve Njerëzore, në të cilin kanë marrë pjesë menaxherët e burimeve njerëzore nga komunat e Kosovës si dhe përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Qëllimi i takimit ishte diskutimi i udhëzimeve administrative që rrjedhin nga Rregullorja e re për procedurën e pranimit në

shërbimin civil.

Në fokus të diskutimeve ishin udhëzimet që kanë të bëjnë me: Procedurat e intervistimit; Organizimin dhe administrimin e testit elektronik; Procedurat për pozitën profesionale dhe pozitën e specialistëve.

Gjatë takimit u theksua se këto udhëzime janë ende në fazë zhvillimi dhe harmonizimi, që paraqet sfidë për nivelin lokal dhe për atë qendror.

Nga diskutimet e zhvilluara ndërmjet pjesëmarrësve u evidentuan një sërë çështjesh procedurale, paqartësi dhe situata të cilat aktualisht nuk janë të mbuluara apo të sqaruara mjaftueshëm përmes



udhëzimeve ekzistuese.

Përfaqësuesit e komunave ngritën shqetësime lidhur me: Mënyrën praktike të zbatimit të testimit elektronik; Standardizimin e procedurave

të intervistimit; Kompetencat dhe përgjegjësitë ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror në procesin e rekrutimit; Nevojën për sqarime shtesë juridike dhe procedurale.

Në përfundim të takimit u vlerësua e nevojshme që komunikimi dhe koordinimi ndërmjet institucioneve qendrore dhe komunave të vazhdojë edhe në periudhën në vijim, me qëllim të adresimit të sfidave të identifikuar dhe hartimit të udhëzimeve sa më të qarta dhe të zbatueshme në praktikë.

Gjithashtu, u theksua rëndësia e përfshirjes së komunave në procesin e konsultimit dhe finalizimit të akteve nënligjore që ndërlidhen me kompetencat e nivelit lokal të respektohet pavarësia institucionale që kanë komunat në raport me nivelin qendror.

## KOSOVA RREZIKON HUMBEN E FONDEVE TË BE-së NËSE VONON ZBATIMIN E AGJENDËS SË REFORMAVE

PRISHTINË, 21 MAJ - Komisioni Evropian ka konfirmuar se ende nuk ka pranuar nga Kosova kërkesën për pagesën e radhës nga fondet e Planit të Rritjes. Afati për dorëzimin e kërkesës është 15 korriku, ndërsa dita e fundit e qershorit paraqet afatin përfundimtar për zbatimin e reformave të parapara për këtë periudhë.

Dorëzimi i kërkesës nga autoritetet vendore është

procedurë e paraparë me rregullat e Planit të Rritjes, ndërsa miratimi i pagesës së kësteve bëhet pasi Komisioni Evropian ta vlerësojë pozitivisht zbatimin e reformave. "Afati i ardhshëm i raportimit për Kosovën do të jetë më 30 qershor. Shpërndarja e fondeve nga BE-ja i nënshtrohet vlerësimit të përbushjes së hapave të Agjendës së Reformave, si dhe



pajtuashmërisë me kushtet dhe parakushtet e përgjithshme. Me skadimin e afatit për 13 reforma më 30 qershor të këtij viti, Kosova

rrezikon të humbasë fonde nëse nuk përparon në zbatimin e Agjendës së Reformave", ka deklaruar një zëdhënës i Komisionit Evropian, raporton RTK.

Vlera e reformave që Kosova duhet t'i zbatojë deri më 30 qershor arrin mbi 90 milionë euro. Siç kanë shpjeguar zyrtarët e Komisionit Evropian, fundi i këtij viti shënon afatin përfundimtar

edhe për 27 hapa të tjerë reformash në vlerë rreth 166 milionë euro.

Nga Komisioni Evropian është porositur se Kosova duhet ta përshpejtojë zbatimin e Agjendës së Reformave për ta shmangur humbjen e këtyre fondeve. Fondet nga Plani i Rritjes, në rast se humben, janë të pakthyeshme dhe kjo vlen për secilin shtet të Ballkanit Perëndimor.

## UP-ja nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit

PRISHTINË, 21 MAJ - Universiteti i Prishtinës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, që mundëson zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve profesionale me interes të dyanshëm. Marrëveshja parasheh bashkëpunim në fushat që lidhen me kompetencat e ministrisë dhe kapacitetet shkencore të UP-së.

Personeli akademik i Universitetit të Prishtinës do ta japë kontributin për

përmirësimin e legjislacionit të Ministrisë, monitorimin e projekteve dhe aktiviteteve profesionale, pjesëmarrjen në komisione, grupe punuese ose mekanizma të tjerë, derisa studentët e universitetit do të përfshihen në aktivitete profesionale dhe kërkimore. Marrëveshja u nënshkrua nga rektori i Universitetit të Prishtinës, prof. Arben Hajrullahu dhe ministrja në detyrë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fitore Pacolli-Dalipi.

Për hartimin e një

marrëveshjeje bashkëpunimi, rektori Hajrullahu dhe ministrja Pacolli-Dalipi ishin pajtuar në takimin e zhvilluar më 4 mars 2026. Atëherë ministrja ishte zotuar që pronat e atakuara të UP-së do të jenë prioritet i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Për pronat e UP-së dhe çështje të tjera, drejtuesit e Universitetit të Prishtinës ishin takuar në muajin prill me drejtues të Këshillit Prokurorial të Kosovës. UP-ja ka arritur marrëveshje bashkëpunimi



edhe me Ministrinë e Drejtësisë dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës në

kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional për të mirën publike.

## BQK-ja DHE BANKAT DISKUTOJNË PËR MODERNIZIMIN E SISTEMEVE TË PAGESAVE

PRISHTINË, 21 MAJ - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe përfaqësues të bankave komerciale, organizoi një punëtori të fokusuar në afatet e zbatimit dhe përgatitjet teknike lidhur me platformën e pagesave të shpejta (TIPS Clone), zbatimin e Ligjit të ri për Shërbimet e Pagesave si dhe përgatitjet operacionale për integrimin e ardhshëm në SEPA. Punëtorja mbledhi përfaqësues nga BQK-ja, sektori bankar dhe ekspertë ndërkombëtarë të angazhuar në projektet e modernizimit të sistemeve të pagesave.

Diskutimet u fokusuan në gatishmërinë operacionale, koordinimin teknik, sigurinë kibernetike, interoperabilitetin, menaxhimin e likuiditetit, masat

për parandalimin e mashtrimeve, qëndrueshmërinë kibernetike, si dhe harmonizimin me standardet evropiane dhe kornizën rregullative në fushën e pagesave.

Gjatë diskutimeve theks i veçantë iu kushtua koordinimit të ngushtë ndërmjet BQK-së, bankave, ofruesve të shërbimeve të pagesave jo banka dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve teknike si dhe partnerëve ndërkombëtarë me qëllim të sigurimit të një zbatimi efikas, të sigurt dhe të qëndrueshëm të fazës së ardhshme të modernizimit të infrastrukturës së pagesave dhe reformave rregullative në Kosovë.

Zëvendësguvernatori për Operacione Bankare, Dardan Fusha, theksoi se modernizimi i sistemeve të pagesave dhe zbatimi i kornizës së re për



shërbimet e pagesave përfaqësojnë ndër projektet më të rëndësishme transformuese për sektorin financiar në Kosovë, duke kontribuar

drejtpërdrejt në ofrimin e shërbimeve financiare më të shpejta, më të sigurt, më të qasshme dhe më efikase për qytetarët dhe bizneset.

Ai theksoi më tej se këto reforma pritet ta forcojnë përfshirjen financiare, ta zgjerojnë qasjen në shërbimet financiare digjitale, ta mbështesin konkurrencën dhe inovacionin në tregun e pagesave, duke avancuar njëkohësisht mbikëqyrjen, qëndrueshmërinë operacionale, sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e konsumatorit në të gjithë sektorin financiar.

BQK-ja mbetet e përkushtuar për ta vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me sektorin bankar, institucionet jobankare të shërbimeve të pagesave, institucionet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë përgjatë zbatimit të projekteve që lidhen me modernizimin e sistemeve të pagesave, përfshirjen financiare dhe integrimin financiar evropian.

## KOSOVA DESTINACION I BESUESHËM PËR INVESTIME NË ENERGJI TË QËNDRUESHME

PRISHTINË, 21 MAJ - Rëndësia e investimeve të qëndrueshme dhe mbështetjes së Bashkimit Evropian në Kosovë për zhvillimin ekonomik të Kosovës ishte në qendër të diskutimeve në Forumin e Tretë të Investimeve të Qëndrueshme.

Në forum morën pjesë përfaqësues të Bashkimit Evropian në Kosovë, përfaqësues institucionalë, përfaqësues të sektorit privat, partnerë zhvillimorë dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, të cilët diskutuan mbi ndikimin e Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian dhe financimit IPA në forcimin e ekonomisë së qëndrueshme dhe rritjen e investimeve në Kosovë.

Në kuadër të forumit sekretarja



e përgjithshme e Ministrisë së Ekonomisë, Leonita Shabani-Mullarama, mori pjesë në panelin me temën "Investime të

qëndrueshme infrastrukturore për një të ardhme me energji stabile dhe mjedis të pastër", ku u diskutua mbi rëndësinë e

investimeve strategjike në energji, infrastrukturë të qëndrueshme dhe tranzicion të gjelbër si shtylla kyçe për zhvillimin afatgjatë ekonomik të vendit.

Ajo gjatë diskutimeve tha se "Kosova ndodhet në një fazë kyçe të tranzicionit energjetik dhe infrastrukturor, me fokus në ndërtimin e një sistemi modern, të qëndrueshëm dhe të harmonizuar me objektivat e Bashkimit Evropian për dekarbonizim. Përmes reformave ligjore, investimeve në energjinë solare, e erës dhe sistemeve të ruajtjes me bateri, Kosova po forcon sigurinë energjetike dhe po krijon një treg më transparent e tërheqës për investitorët.

Ajo shtoi se "sektori i energjisë së

ripërtërisht paraqet një nga mundësitë më premtuese për investime, ndërsa transparenca dhe përfshirja e qytetarëve në këto procese mbetet prioritet për realizimin e tyre".

Në fund Sekretarja Shabani-Mullarama i ka ftuar investitorët ndërkombëtarë ta shohin Kosovën si partnere e besueshme dhe treg me potencial të lartë për investime afatgjatë dhe të qëndrueshme në energji.

Diskutimet e forumit u fokusuan në prioritetet strategjike për zhvillimin ekonomik të vendit, fuqizimin e sektorit privat dhe rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme të Bashkimit Evropian përmes instrumenteve financiare dhe programeve zhvillimore në Kosovë.

## AKK-ja AKUZON MINISTRINË E FINANCAVE PËR MOSFUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË TATIMIT NË PRONË

PRISHTINË, 21 MAJ - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka reaguar ndaj Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Tatimit në Pronë, duke i akuzuar për neglizhencë lidhur me, siç thuhet, mosfunksionimin e plotë të sistemit të ri të tatimit në pronë, i cili është lansuar në gusht të vitit 2025.

Në reagimin e AKK-së thuhet se është e papranueshme që edhe pas nëntë muajsh komunat të vazhdojnë të përballesh me një sistem jofunksional, pa afate konkrete dhe pa përgjegjësi institucionale nga niveli qendror. "Është e papranueshme që edhe pas 9 muajsh, komunat vazhdojnë të përballesh me një sistem jofunksional, pa afate konkrete dhe pa asnjë përgjegjësi

institucionale nga ana e nivelit qendror", thuhet në reagim.

AKK-ja thotë se pasojat e kësaj situatë po reflektohen drejtpërdrejt si në buxhetet komunale ashtu edhe te qytetarët, duke përmendur humbje të të hyrave vetjake dhe penalizime përmes interesave dhe gjobave. "Si pasojë direkte e kësaj neglizhence: komunat po humbin miliona euro të hyra vetjake; qytetarët po penalizohen padrejtësisht me interesa dhe gjoba; janë bllokuar procedurat e rillogaritjes dhe regjistrimit të pagesave; parapagimet nuk shfaqen saktë në sistem; është cenuar seriozisht besueshmëria institucionale ndaj komunave", thuhet më tej.

Sipas AKK-së, pavarësisht prej kërkesave të vazhdueshme të



komunave për sqarime dhe ndërhyrje urgjente, Ministria e Financave "ka zgjedhur heshtjen dhe neglizhencën", duke i lënë komunat dhe qytetarët të përballesh me pasojat.

AKK-ja vlerëson se situata tashmë nuk është vetëm çështje teknike, por "dështim serioz institucional" që po dëmton financat komunale dhe funksionimin e administratës

lokale. "Asociacioni i Komunave të Kosovës konsideron se kjo situatë nuk është më vetëm problem teknik, por dështim serioz institucional që po dëmton rëndë financat komunale dhe funksionimin normal të administratës lokale", thuhet në reagim.

Në fund, AKK-ja ka kërkuar urgjentisht funksionalizimin e plotë të sistemit, një raport transparent publik mbi problemet dhe përgjegjësit, eliminimin e penaltiteve të padrejta ndaj qytetarëve dhe kompensimin e dëmeve financiare që, sipas tyre, komunat po i pësojnë. "Komunat nuk mund ta mbajnë barrën e paaftësisë dhe mosveprimit të institucioneve qendrore", përfundon reagimi.

# KUBA MUND TË KETË FATIN E VENEZUELËS: SHBA ZHVENDOS AEROPLANMBAJTËSEN NIMITZ DREJT KARAIIBEVE



Me aktakuzën ndaj Raul Castros, komploti venezuelian duket se po përsëritet në Kubë. Kjo demonstron edhe nga mbërritja në Karaibet jugore e aeroplanmbajtëses me energji bërthamore Nimitz dhe grupit të saj goditës, megjithëse një burim qeveritar siguroi New York Times se kjo ishte një “shfaqje force dhe jo një operacion i madh ushtarak”, siç u bë me aeroplanmbajtësen Gerald Ford për të kapur Nicolás Maduro. Sidoqoftë, për Donald Trump, kapja dhe burgosja e presidentit venezuelian përfaqëson “skenarin perfekt” që administrata e tij synon ta imitojë për të riorganizuar qeveritë “armiçësore” ndaj SHBA-së në të gjithë botën. Pas bastisjes së suksesshme kundër diktatorit në Karakas Trump u përpoq, pa sukses, me qeverinë e ajatollahëve në Teheran. Tani, një tranzicion “në stilin venezuelian” po afrohet edhe për Kubën. Por a është i realizueshëm në Ishullin e Revolucionit? “Modeli i Karakasit” është i thjeshtë. Prit kokën udhëheqësit suprem, mbaj shumicën e zyrtarëve të nivelit të mesëm në pushtet për të siguruar stabilitetin administrativ dhe menjëherë arrin një sërë marrëveshesh ekonomike dhe tregtare me këta udhëheqës të rinj. Demokracia, shkurt, kalon në plan të dytë. Në Venezuelë, presidentja e

përkohshme Delcy Rodríguez ka punuar në harmoni të plotë me Shtëpinë e Bardhë që nga dita e parë, pas kapjes së Maduros më 3 janar dhe transferimit të tij në Nju Jork për gjyq. Njëzet e gjashtë vjet “çavizëm” duket se janë fshirë brenda natës në emër të biznesit të ri të naftës. Me sa duket, sepse udhëheqja ushtarake, një bastion i diktaturës, është ende fort në kontroll dhe zgjedhjet demokratike aktualisht janë jashtë diskutimit. Por Havana nuk është Karakas, paralajmërojnë ata që janë të njohur me regjimin e Kastros. Dhe nuk ka gjasa që “Kastroizmi me vulën e Xhaxha Samit” të vendoset. Përtej unitetit të dukshëm të qeverisë komuniste pas figurës së Raul Castros mbi 90 vjeç dhe pavarësisht shpërthimeve pro-kapitaliste të njërit prej nipërve të tij, pengesa kryesore qëndron në Shtetet e Bashkuara, jo në Kubë. “Në bisedat e mia me njerëz në administratë, nuk shoh vend për udhëheqësit aktualë, as për presidentin dhe as për familjen Castro. Jam i bindur se qëllimi përfundimtar i Trump është një ndryshim i qeverisë në Kubë, në një afat shumë të shkurtër”, tha Hugo Cancio, një sipërmarrës kubano-amerikan me ndikim nga Miami, për Mondo Capovolto të Corriere. Ai është krijuesi i platformës së tregtisë elektronike Katapult, një lloj Amazon që u lejon të

mërguarve të porosisin dhe t’u dërgojnë miqve dhe të afërmeve mallra që përndryshe nuk do të ishin të disponueshme në ishull. Ndryshe nga Venezuela, të mërguarit kubanë kanë krijuar një rrjet të fuqishëm politik, të integruar në mënyrë të përkryer në institucionet e Uashingtonit, 11 anëtarë të Kongresit të Shteteve të Bashkuara janë me origjinë kubaneze dhe po ushtrojnë presion të fortë dhe të vazhdueshëm mbi Administratën me qëllim përmbysjen e regjimit në Havana. Pa përmendur që shumë udhëheqës lokalë dhe kombëtarë janë ngritur në pushtet duke e bazuar mbështetjen e tyre elektorale pikërisht në premtimin e ndryshimit drastik të regjimit në Kubë. Komuniteti kubanez në Miami nuk do ta pranonte kurrë një zgjidhje hibride. Sekretari i Shtetit dhe kandidati presidencial i lindur në Kubë, Marco Rubio, të cilit i janë besuar negociatat (jo sekrete) me nipin gjithnjë e më të fuqishëm të Raúl Castros, Raúl Rodríguez Castro, është i vetëdijshëm se “modeli venezuelian” nuk do të pranohet kurrë nga komuniteti i tij, i cili përfaqëson një segment të konsiderueshëm të elektoratit. Kjo është konfirmuar pjesërisht nga sondazhi i fundit i Qendrës Kërkimore Peë mbi vlerësimin e miratimit

të presidentit amerikan midis votuesve hispanikë, vetëm 66% e latino-amerikanëve që votuan për Trump në vitin 2024 ende e miratojnë performancën e tij, një rënie prej 27 pikësh përqindjeje që nga fillimi i mandatit të tij të dytë. Vetë Rubio shpjegoi se Kuba “pranoi” ofertën e SHBA-së për ndihmë humanitare me vlerë totale 100 milionë dollarë. Nëse “zgjidhja venezueliane” dështon, pushtimi mbetet. Dhe këtu hyjmë në një skenar krejtësisht të paparashikueshëm, me disa të panjohura të mëdha. Si do të sillej ushtria kubaneze, e trajnuar për besnikëri absolute? Dhe cili do të ishte reagimi i kubanezëve, një popull i dorëzuar që ka qenë i uritur për demokraci për shumë vite, i përbërë kryesisht nga gra, të moshuar dhe fëmijë, sepse të rinjtë kanë ikur nga ishulli në masë? Revolucionari kubanez ka qenë në pushtet që nga viti 1959. Ndryshe nga Venezuela, e cila përjetoi “Çavizmin” vetëm në vitin 1998, nuk ka opozitë të vërtetë politike në ishull. Vetëm disa grupe disidente, kryesisht të afërta me Kishën Katolike dhe të mbrojtura nga ajo, kanë mbetur. “Venezuelianët dëshirojnë një kthim në ditët e lavdisë së bumit të naftës së shekullit të 20-të, kubanezët dëshirojnë një fillim të ri”, shkruan Politico. Edhe të rinjtë, megjithatë, e

dinë, sepse nuk kanë pushuar kurrë së mësuarit atë në shkollat revolucionare, se Kuba ishte prej kohësh “në pronësi” të Shteteve të Bashkuara, dhe para revolucionit, “interesat amerikane përvetësonin rreth gjysmën e sheqerit të prodhuar me çmime të reduktuara, zotëronin rreth një të tretën e të gjitha fabrikave të sheqerit, një të tretën e shërbimeve publike, 90% të të gjithë prodhimit të energjisë elektrike dhe gati një të katërtën e territorit të ishullit”. Trump po kërkon një fitore politike, për të qetësuar votuesit e tërbuar “nga lufta e gjatë në Iran dhe rritja e çmimeve të benzinës”, shkruan Neë York Times. Dhe shefi i CIA-s, John Ratcliff, gjatë vizitës së tij të fundit historike në Havana, i lëshoi një ultimatum Ministrisë të Brendshme Kubanë Lázaro Casas dhe Raúl Rodríguez Castro. “Do të ishte për të ardhur keq nëse diçka e keqe do t’i ndodhte këtij ishulli të bukur”, thuhet se tha ai, në stilin e shefit, në të njëjtën ditë kur Havana pranoi se rezervat e saj të fundit të karburantit po mbaronin. Sapo të mbarojnë kërcënimet, çdo vendim nuk do të jetë i lehtë dhe do të ketë pasoja të paparashikueshme.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Granit Xhaka shpallet lojtari i vitit te Sunderlanti

SUNDERLAND, 21 MAJ - Granit Xhaka është shpallur lojtari më i mirë i sezonit te skuadra e Sunderlanti. Xhaka ka ardhur në këtë sezon te Sunderlanti, i cili sapo ishte promovuar në Premierligë. Ai është përshkruar si zemra e

mesfushës së Sunderlanti, një lider brenda dhe jashtë fushës, i cili ka luajtur rol kyç gjatë tërë sezonit, ku ekipi ka arritur të sigurojë qëndrimin në Premierligë. "Kapiteni ynë. Lideri ynë. Lojtari ynë i sezonit. Përgëzime, Granit Xhaka!", ka shkruar

Sunderlanti në rrjetet sociale. Futbollisti shqiptar që luan për Kombëtaren e Zvicrës është bërë menjëherë kapiten dhe lider i ekipit, duke i udhëhequr drejt një performace mjaft të mirë këtë sezon. Xhaka ka

shënuar 1 gol për Sunderlanti dhe ka bërë 6 asistime në 33 ndeshje, kurse në total ka 35 paraqitje deri më tani në të gjitha garat. Sunderlanti ka gjasa që të fitojë njërin ndër vendet që e dërgojnë edhe në kupat evropiane.



## PËRFAQËSUESI I UEFA-S VIZITON KOSOVËN, FOKUS ZHVILLIMI I REFERIMIT DHE STANDARDEVE NË FUTBOLL

Prishtinë, 21 maj - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka pritur në takim Nuno Castel, përgjegjës i Konventës së Referëve për Kosovën, deleguar nga UEFA. Ademi ka theksuar se vizita e tij përbën një moment të rëndësishëm për zhvillimin dhe avancimin e referimit në vendin tonë, duke reflektuar përkushtimin e vazhdueshëm të UEFA-s për ngritjen profesionale të gjyqtarëve të Kosovës dhe forcimin e

standardeve në futbollin tonë. "Gjatë takimit zhvilluam diskutime shumë konstruktive rreth sfidave, objektivave dhe perspektivës së referimit në Kosovë. Përvoja, profesionalizmi dhe vizioni i Castel do të jenë vlerë e madhe për sistemin tonë të referimit, ndërsa mbështetja e UEFA-s mbetet thelbësore në rrugëtimin tonë drejt profesionalizmit, integritetit dhe rritjes së cilësisë në çdo nivel të garave. Kosova po dëshmon çdo ditë se ka



potencial, talent dhe kapacitete për të ndërtuar një sistem modern, të besueshëm dhe të standardeve evropiane në referim. Takime të këtij niveli janë dëshmi e qartë se puna, përkushtimi dhe vizioni ynë po vlerësohen dhe po marrin mbështetje nga institucionet më të rëndësishme të futbollit evropian", ka shkruar kreu i FFK-së në "Facebook". Me këtë rast, Ademi i ka shprehur gatishmërinë e tij dhe të Federatës së Futbollit të

Kosovës Nuno Castel për ta vazhduar bashkëpunimin e ngushtë në funksion të avancimit të referimit të Kosovës dhe krijimit të më shumë mundësive për gjyqtarët tanë në arenën ndërkombëtare. "Besoj fuqishëm se përmes bashkëpunimit, vizionit të përbashkët dhe punës së pandalshme, do të vazhdojmë të ndërtojmë një të ardhme edhe më të fortë për referimin dhe futbollin e Kosovës", ka shkruar Ademi.

## ASTON VILLA E UNAI EMERY FITON LIGËN E EVROPËS

Stamboll, 21 maj - Aston Villa është fituese e Ligës së Evropës, pasi në finale ka mposhtur bindshëm Freiburgun me rezultat 3-0, duke e zgjidhur ndeshjen praktikisht që në pjesën e parë dhe duke e menaxhuar pa probleme epërsinë në vazhdim.

Anglezët e kanë nisur më mirë takimin dhe krijuan raste që në minutat e para, me Morgan Rogers që disa herë ishte pranë golit. Freiburgu ka pasur momentin e tij më të mirë në minutën e 17, kur Hofler ka shpërdoruar një rast të madh nga afërsia, por kjo ka rezultuar vendimtare, pasi Villa është bërë më konkrete. Goli i parë ka ardhur në minutën e 41-të. Morgan Rogers ka asistuar për Youri Tielemans, i cili i pambuluar në zonë ka goditur me të parën, duke e dërguar topin në rrjetë për 0-1. Në kohën shtesë të pjesës së parë, Aston Villa e ka dyfishuar epërsinë, me John McGinn që



ka shërbyer për Emiliano Buendian, i cili ka realizuar një gol të bukur me goditje të harkuar në këndin e sipërm për 0-2. Në pjesën e dytë Freiburgu është përpjekur të reagojë, por ekipi anglez e ka mbyllur përfundimisht finalen në minutën e 58. Buendia ka

dhuruar asist dhe Morgan Rogers ka treguar qetësi brenda zonës, duke e vendosur saktë topin në këndin e poshtëm për 0-3. Me këtë fitore Aston Villa e ka mbyllur sezonin evropian në mënyrën më të mirë të mundshme, duke e fituar trofeun me një paraqitje të madhe në finale,

ndërsa Freiburgu ka mbetur pa trofe, i pamundur për ta përballuar ritmin dhe cilësinë e anglezëve në natën

vendimtare. Aston Villa e ka fituar këtë garë pas 44 vjetësh, ndërsa Unai Emery ka fituar trofeun e pestë në këtë garë.

## Trepça shpallet kampione për të tretin vit radhazi

PRIZREN, 21 MAJ - Trepça ka vazhduar dominimin në elitën e basketbollit të Kosovës, duke u shpallur sërish kampione. Në palestrën "Sezai Surroi" në Prizren, mitrovicasit e kanë mposhtur Bashkimin me rezultat 98:78 në ndeshjen e katërt finale, duke e mbyllur serinë me 4:0. Për Trepçën ky është titulli i shtatë në histori të klubit dhe i treti rresht, që e ka ngjitur në pozitën e skuadrës së dytë më



të suksesshme në Kosovë. Me këtë triumf Trepça e ka kaluar Pejën (6 tituj), ndërsa në krye të listës mbetet Sigal Prishtina me 14 tituj. Trepça i ka fituar titujt kampionë në vitet 1993, 2000, 2001, 2012, 2024, 2025 dhe tani edhe në këtë edicion. Në anën tjetër, Bashkimi mbetet me vetëm një titull kampioni, të fituar në vitin 2018, ndërsa kjo ishte finalja e dytë radhazi ndaj Trepçës, pas humbjes edhe në edicionin e kaluar.

## Fenerbahçe synon transferimin e Alban Hajdarit

Stamboll, 21 maj - Mbrojtësi i Kombëtares së Kosovës, Alban Hajdari, ka gjasa që karrierën ta vazhdojë në Superligën e Turqisë. Është bërë me dije se kandidati për president të Fenerbahçes, Aziz Yildirim, ka premtuar transferimin e Hajdarit nëse fiton zgjedhjet që

mbahen më 7 qershor në klubin turk. Siç kanë raportuar mediet turke, Yildirim po bëhet gati për ta kontaktuar zyrtarisht skuadrën e Hoffenheimit për Hajdarin, i cili vlerësohet lart te klubi gjerman. Ai te Fenerbahçe është duke u konsideruar investim afatgjatë

për repartin e mbrojtjes dhe tashmë po monitorohet nga afër. Hajdari ka kontratë me Hoffenheimin deri në verën e vitit 2031 dhe kartoni i tij vlerësohet të paktën 20 milionë euro. 23-vjeçari në verën e shkuar është transferuar te

Hoffenheimi nga Lugano dhe në sezonin e tij të parë në Bundesligë, Hajdari ka shënuar 1 gol dhe ka bërë 2 asistime në 30 paraqitje. Ai ka edhe pesë paraqitje me Kombëtaren e Kosovës, ndërsa me "Dardanët" ka debutuar në muajin tetor të vitit të shkuar.





# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “A&G Partners” Sh.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 812296946 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “A&G Partners” D.O.O. od Gjakovica, donelo odluku o prestani rada sa nrB. 812296946 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “A&G Partners” L.L.C. with headquarters Gjakova, has come to the decision to quit its business: 812296946 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Bleranta Luboja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl. 1-8.
- Blerina Lushaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e sh.m/ mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Arjana Kukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “Leke Dukagjini” Prizren.
- Sabit Ferati shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore “Ukshin Miftari”, Skivjan-Gjakovë.
- Çlirim Gjuraj nga Gërçina e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U “7 Shtatori”, nga klasa e 6-9.
- Fitim Syla shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. “7 Shtatori” Prishtinë.
- Vilson Gjyckaj nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U “Engjëll Gjoni”, Novosellë, nga klasa 1-8.
- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “Fehmi Agani” Baçelor i Edukimit Fillor.
- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.
- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12.
- Beqir Cenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Bedri Smolica shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Buna Sada shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Albrim Syla shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

**TRADITË QË NGA**

**1992**

